

KUSHTET DHE TERMAT E PËRDORIMIT TË FAQES WEB

Këto Kushte dhe Terma ("Terms & Conditions") rregullojnë përdorimin e website-it të operuar nga Banka Jet SH.A. ("Jet Bank"). Duke aksesuar ose përdorur këtë website, ju pranoni të respektoni këto Terms & Conditions.

QËLLIMI I WEBSITE-IT

Ky website ofrohet ekskluzivisht për qëllime informuese dhe komunikimi paraprak. Jet Bank ndodhet në fazë para-lançim dhe është në procesin e përgatitjes për fillimin e aktivitetit bankar, në përputhje me kërkesat rregullatore të Bankës së Shqipërisë.

MUNGESA E OFERTËS BANKARE

Asnjë informacion i publikuar në këtë website nuk përbën ofertë, ftesë për kontraktim, rekomandim apo këshillë financiare, bankare apo investimi. Përmbajtja e website-it nuk synon dhe nuk duhet të interpretohet si ofrim i produkteve ose shërbimeve bankare.

WAITING LIST

Regjistrimi në waiting list shërben vetëm për të shprehur interes dhe për të marrë informacione të përgjithshme mbi lançimin e ardhshëm të Bankës. Ky regjistrim nuk krijon marrëdhënie kontraktuale, klient-bankë apo detyrime reciproke ndërmjet individit dhe Jet Bank.

KOMUNIKIME MARKETINGU

Nëse përdoruesi jep pëlqimin e veçantë për komunikime marketingu, Jet Bank mund të përdorë të dhënat e kontaktit të ofruara për t'i dërguar informacione lidhur me lançimin e Bankës dhe, pas marrjes së licencimit përfundimtar, mbi produktet dhe shërbimet që mund të ofrohen.

Ky pëlqim jepet përmes një checkbox-i të ndarë dhe jo të parazgjedhur dhe është i pavarur nga regjistrimi në waiting list. Përdoruesi ka të drejtë ta tërheqë pëlqimin në çdo kohë, pa pasoja, nëpërmjet mekanizmave të thjeshtë të vënë në dispozicion nga Banka. Për më shumë informacion, ju lutemi referojuni Politikës së Privatësisë.

PRONËSIA INTELEKTUALE

E gjithë përmbajtja e website-it, përfshirë tekstet, logot, dizajnet, grafikët dhe elementët e tjerë vizualë, është pronë ekskluzive e Jet Bank ose e palëve të treta që kanë dhënë autorizimin përkatës. Çdo përdorim, riprodhim ose shpërndarje pa autorizim paraprak është i ndaluar.

KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË

Jet Bank nuk mban përgjegjësi për ndonjë vendim, veprim ose mosveprim të ndërmarrë nga përdoruesit bazuar në informacionin e publikuar në këtë website gjatë fazës para-lançim. Banka rezervon të drejtën të përditësojë, ndryshojë ose heqë përmbajtjen e website-it në çdo kohë.